



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:251823
Datë: 07.08.2024
Numri i dokumentit: 06027886

K.DH.Shk II.nr. 908/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbaremore të kreditorit “Kralini Group” Sh.p.k, me nr. unik identifikues 811450345, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arbër Shala nga Prishtina, kundër debitorit “Andi Group 2004” sh.p.k, me nr. unik identifikues 811291046 me seli në Gjilan rr. “Abdullah Tahiri” nr.70, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Fadil Sinanaj nga Gjilani, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2504/22 të datës 31.01.2024, me datë **07.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Andi Group 2004” sh.p.k, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2504/22 të datës 31.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2504/22 të datës 31.01.2024, pikën I të dispozitivit e aktvendimit është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas kërkesës së debitorit “Andi Group 2004” sh.p.k, për shtyrje të përmbaremit në lëndën përmbaremore sipas Urdhrit Përmbaremit P.nr.303/22 të datës 04.11.2022, të Përmbaremit Privat Irfan I.Kërçagu. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka hedh poshtë si të palejuar kërkesa e debitorit Andi Group

2004 Sh.p.k, për shtyrje të përbarimit në lëndën përbarimore sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.303/22 të datës 04.12.2022 të Përbaruesit Privat Irfan I.Kërçagu.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2504/22 të datës 31.01.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Kralini Group” Sh.p.k, ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm/faturave, duke urdhëruar debitorin që për faturat e lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 5,797.72 € (pesë mijë shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e dy euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga data 16.06.2021 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore. Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, të cilin gjykata me aktvendimin KPPP.nr.2504/22 të datës 08.11.2023 e ka refuzuar si të pabazuar.

Ndërsa, me aktvendimin KPPP.nr. 2504/22 të datës 23.11.2023, gjykata ka urdhëruar debitorin që të paguaj shumën e garancisë në vlerë prej 5,797.72 EUR si parakusht për shqyrtimin e ankesës së parashtruar nga debitori ndaj aktvendimit KPPP.nr. 2504/22 të datës 08.11.2023, duke e paralajmëruar debitorin se në rast të mos pagesës së garancisë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 15.09.2023 ka paraqitur parashtresë drejtuar kësaj gjykate duke kërkuar lirimin nga pagesa e garancisë si parakusht për trajtimin e ankesës së ushtruar me datë 01.12.2023, ndërsa Gjykata, me aktvendimin KPPP.nr. 2504/22 të datës 08.12.2023, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e debitorit, ashtu që ka ndryshuar lartësinë e garancisë së caktuar me aktvendimin e datës 23.11.2023, duke detyruar debitorin që tanimë të paguaj garanci në vlerë prej 2,000.00 EUR si parakusht për shqyrtimin e ankesës së ushtruar ndaj aktvendimit Aktvendimit KPPP.nr. 2504/22 të datës 08.11.2023.

Debitori, nuk ka vepruar sipas këtij aktvendimi, por me datë 27.12.2023, ka paraqitur kërkesë për shtyrje të përbarimit, me arsyetimin se debitori nuk mund të përmbush borxhin e caktuar sipas urdhrit përbarimor si dhe nuk mund të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga kjo Gjykatë, kjo për faktin se debitori gjendet në një numër të madh të procedurave përbarimore, ashtu që çfarëdo pagese do t’i shkaktonte dëme të pariparueshme sepse nuk do kishte mundësi që t’i përmbush kërkesat e debitorëve.

Gjykata Komerçiale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të përmbarrimit dhe analizimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për shtyrje të përmbarrimit është e paljeuar. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të përmbarrimit është organi përmbarrimit, përkatësisht Përmbarruesi Privat i cili ka lejuar urdhrin përmbarrimor, ndërsa përjashtimisht, në kuptim të nenit 61 par. 11 të LPP-së, gjykata është kompetente për të trajtuar kërkesën për shtyrje të përmbarrimit vetëm në rastet kur vet gjykata paraqitet si organ përmbarrues ose kur ka juridiksion për të vendosur për ankesë kundër urdhrin përmbarrimor e në të cilat raste gjykata mund edhe të mos e obligoj debitorin që të deponoj pengun kur debitori merr pjesë në procedurë si palë, nëse përcakton gjasën se përmbarrimi do të shkaktoje dëmtim të pariparueshëm apo nëse përcakton gjasën se shtyrja është e domosdoshme me qëllim të parandalimit të dhunës, situata këto që gjejnë aplikim në rastin konkret.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i shkallës së parë me të drejtë është bazuar në nenin 61 paragraf 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do të shkaktoj atij dëm të pariparueshëm, organi përmbarrues plotësisht apo pjesërisht do të shtyjë përmbarrimin, në rastet kur është parashtruar ankesë kundër dokumentit përmbarrues dhe pala ankuese i demonstroi gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo gjykatës i ka parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin ”*, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen, përcaktohet se: *“ Para se të vendos për shtyrje të përmbarrimit, organi përmbarrues do të siguroj kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes ”*. Tutje, sipas paragrafit 4 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Organi përmbarrues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarrimin në situata kur debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarrimi do të shkaktoj dëm të pariparueshëm dhe jep garanci shumë të pakë të korresponduar me shumën e kërkesës ”*.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerçiale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se kompetent për të vendosur për shtyrjen është organi përmbarrues në rastin konkret është Përmbarruesi Privat i cili ka lejuar urdhrin përmbarrimor ndërsa gjykata nuk është kompetente për të vendosur lidhur me ankesën.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II nr.908/24 me datë 07.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami